REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

# RREGULLORE
# PËR
# REKRUTIMIN E PERSONELIT AKADEMIK DHE NDIHMËS AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS

**Miratuar me Vendim nr. 114, datë 30.09.2025 të**
**Senatit Akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës, ndryshuar me Vendimin nr.120 datë 08.09.2026 dhe me Vendim nr. 142, datë 30.10.2026**

30 Tetor 2026



Rr. Muhamet Gjollesha, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

**MODALITETE**
**PËR CAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR PUNËSIMIN E PERSONELIT AKADEMIK DHE NDIHMËS AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS**

Mbështetur në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurave Administrative, të Ligjit nr. 80/2015, "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë*", Statutin dhe Rregulloret e UST-së, në Strukturën organizative të institucionit dhe nevojat për personel akademik, punësimi i personelit në UST është i hapur, publik dhe procedura e aplikimit dhe konkurrimit të kandidatëve kalon nëpërmjet një procesi transparent e të paanshëm. Kjo procedurë shpallet publikisht dhe është e miratuar nga Senati Akademik, organi më i lartë vendimmarrës i institucionit.

- Vendi i lirë i punës shpallet në faqen zyrtare të institucionit dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike (APP). Për vendin e lirë të punës konkurrohet.
- Kriteret e përgjithshme të punësimit përcaktohen në statutin e UST-së.
- Kriteret specifike dhe preferenciale të punësimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit dhe miratohen nga Rektori pasi përcillen nga drejtuesi i njësisë kryesore.
- Rektori miraton komisionin *ad hoc* sipas propozimeve të njësisë kryesore dhe cakton një anëtar nga rektorati për rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë.
- Komisioni *ad hoc* shqyrton dosjet e kandidatëve në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit duke verifikuar përputhshmërinë e informacionit të paraqitur nga kandidati në formularin e aplikimit me dokumentacionin përkatës.
- Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Arkiv/Protokollit çertifikon kandidatët që kanë plotësuar të gjithë listën e dokumentave të kërkuara për aplikimin dhe kandidatët që e kanë të plotë dosjen i kalojnë komisionit ad hoc për shqyrtimin e vlerësimin e tyre. Gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit dokumentar të dosjeve të paraqitura nga kandidatët, çdo anëtar i komisionit ad hoc i vlerëson me pikë në mënyrë të pavarur ato sipas një skeme formulari vlerësimi e cila është standarte.
- Kandidatët që vlerësohen se nuk kanë përputhshmëri të dokumentacionit me deklarimin që kanë bërë në formularin e aplikimit, ndërpresin garën e konkurimit gjatë kësaj faze.
- Për kandidatët aplikantë që nuk plotësojne kriterin minimal për të vazhduar garën, komisioni me një vendim të tij nuk i kalon në fazën e dytë të konkurrimit, atë të intervistës.
- Kandidatët që kalojnë pragun minimal, kalojnë në fazën e dytë të vlerësimit nga ana e komisionit, atë të intervistës.
- Burimet Njerëzore njoftojnë elektronikisht kandidatët që kanë kaluar fazën e parë për t'u paraqitur për intervistë në datën dhe orën e caktuar nga komisioni ad hoc sipas një grafiku orar. Po ashtu njoftohen edhe kandidatët jo fitues të fazës së parë.



Rr. Muhamet Gjollesha, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

- Pas përfundimit të intervistës anëtarët e komisionit ad hoc në mënyrë të pavarur vlerësojnë ***kandidatët sipas formularit të vlerësimit standart me pikët totale.***
- Pas mbledhjes së formularëve të vlerësimit nga çdo anëtar i komisionit ad hoc, kryetari i komisionit llogarit mesataren e vlerësimit për çdo kandidat duke i rreshtuar ato në një listë nga kandidati me pikët më të larta deri te kandidati me pikët më të ulëta.
- Rektori shpall fituesin e procedurës sipas listës së paraqitur nga komisioni ad hoc.
- Rektori emëron kandidatin fitues dhe nënshkruan kontratën e punës në cilesinë e punëdhënësit.
- Vlerësimi i kandidaturave për personel akademik bazohet në plotesimin e kritereve të përgjithshme, specifike dhe preferenciale të kandidateve aplikant sipas pikëzimit total të mëposhtëm:

  a. Plotësimi i kritereve të përgjitheshme është kusht i detyrueshëm;
  b. Plotësimi i kritereve specifike;
  c. Plotësimi i kritereve preferenciale;
  d. Performanca në intervistë.

***Totali i pikëve është 100 pikë***, nga të cilat 70 pikë nga dosja dhe 30 pikë nga intervista. Në rast se një nga kandidatët nuk ka marrë të pakten 50 pikë ***(50% të pikëve totale)*** komisioni vendos përfundimin e proçedurës së këtij kandidati pa u përzgjedhur.

- Në rast se kandidatët janë me pikë të barabarta, atëherë renditja bëhet nëpërmjet shortit.
- Procedura e konkurrimit dhe e punësimit është e vlefshme edhe në rastet kur paraqitet vetëm një kandidaturë e cila plotëson kriteret e vendosura për konkurrim.

**E DREJTA E ANKIMIMIT**

- Ankesat në lidhje me vlerësimin e kandidatëve dhe zbatimin e procedurave nga komisioni *ad hoc*, paraqiten me shkrim tek Rektori së bashku me pretendimet, brenda 2 (dy) ditëve pune nga dita e marrjes së njoftimit mbi rezultatet e konkursit nëpërmjet postës elektronike.
- Ankesa percillet tek komisioni ad hoc. Ankesa zgjidhet brenda 3 (tre) ditëve të punës nga data e përfundimit të afatit të ankimit.
- Në përfundim, komisioni ad hoc merr vendim për pranimin ose rrëzimin e ankesës, vendim i cili i njoftohet kandidatit nëpërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit.
- Nëse ankesa pranohet, Rektori vendos të anullojë procesin si të pavlefshëm duke kërkuar ripërsëritjen e tij.

Mbas kalimit të afatit kohor të paraqitjes së ankesave apo shqyrtimit të tyre, Rektori merr vendim emërimi për fillimin e marrëdhënieve të punës.



Rr. Muhamet Gjollesha, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

## A. PROCEDURA E PUNËSIMIT PËR PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS

### I. SHPALLJA PUBLIKE E KONKURRIMIT:

1. Në web-site të UST-së dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike bëhet shpallja e konkurrimit për punësimin e personelit akademik.
2. Shpallja publike e konkurrimit duhet të përmbajë këto të dhëna:
   a. pozicioni për vendin vakant;
   b. numri i personelit të kërkuar për pozicionin/et e kërkuara;
   c. kritere të përgjithshme të kualifikimit;
   d. kritere specifike të kualifikimit;
   e. kriteret preferenciale te kualifikimit;
   f. dokumentet që duhet të dorëzohen;
   g. mënyrën dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit;
   h. afatin e zhvillimit të procedurave të konkurrimit.

### II. KRITERET E KUALIFIKIMIT:

Kriteret e kualifikimit përbëhen nga kritere të përgjithshme, kritere specifike dhe kritere preferenciale të kualifikimit.

***Kriteret e përgjithshme*** të kualifikimit sipas kategorive të personelit akademik janë si më poshtë:

1. ***Për personel akademik të kategorisë "Profesor":***
   a. Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës;
   b. Të mbajë të paktën titullin shkencor "Profesor i Asociuar";
   (Titulli akademik i lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
   c. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
   d. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
   e. Të mos ketë prishur imazhin e UST-së.

2. ***Për personel akademik të kategorisë "Lektor":***
   a. Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës;
   b. Të mbajë të paktën gradën shkencore "Doktor";
   (Grada shkencore e mbrojtur në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
   c. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
   d. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
   e. Të mos ketë prishur imazhin e UST-së.



Rr. Muhamet Gjollesha, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

3. ***Për personel akademik të kategorisë "Asistent-Lektor":***
   a. Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës. Ai duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, "Master i shkencave" ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
   b. Të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të mbi 8-të. Nqse njëri nga kandidatët ka mbaruar specilizime afatgjata do të ekuivalentohet nota mestare me studimet Bachelor, Master i Shkencave dhe Specilizime afatgjata;
   c. Të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht);
   d. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
   e. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
   f. Të mos ketë prishur imazhin e UST-së.

***Kriteret specifike*** dhe ato preferenciale të kualifikimit të propozuara nga njësia bazë përkatëse i përcillen për miratim Rektorit nga Drejtuesi i Njësisë Kryesore.

Procedura e konkurrimit dhe e punësimit është e vlefshme edhe në rastet kur paraqitet vetëm një kandidaturë e cila plotëson kriteret e vendosura për konkurrim.

## III. PROCESI I DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT

**1. Lista e dokumenteve që duhet të paraqesë kandidati për konkurrim**
   a. Aplikimi i plotësuar (formulari tip) dhe firmosja e tij në çdo faqe.
   b. Shprehje e interesit nga ana e kandidatit me shkrim për plotësimin e vendit vakant duke shprehur në të edhe vizionin e tij për këtë pozicion.
   c. Biografi e punës mundësisht me eksperiencat që lidhen me vendin e punës për të cilin aplikon kandidati.
   d. Kopje e noterizuar e diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
   e. Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm origjinal ose të noterizuar, sipas plotësimit të kritereve të shpallura.
   f. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti)/ formulari i vetëdeklarimit.
   g. Letra rekomandimi nga profesorë të fushës.
   h. Fotokopje të dëshmive të kualifikimeve të ndryshme, të noterizuara.
   i. Liste të punimeve shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare profesionale/shkencore dhe/ose punime të tjera, pjesëmarrje në referime shkencore në konferenca etj.; (mundësisht linku i artikullit ose konferences. ISBN ose ISSN të artikujve ose botimeve).



Rr. Muhamet Gjollesha, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

**2. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit**

Dorëzimi i dokumentacionit të plotësuar sipas kritereve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, mund të bëhet dhe on-line në faqen e UST-së ose me postë sipas afateve të shpallura:

- Në rastin e aplikimit online në faqen zyrtare të UST-së, kandidati është i detyruar që të dorëzojë edhe fizikisht dosjen e tij të aplikimit ditën që do të ftohet për intervistë nëse kalon fazën e parë të aplikimit.
- Kandidati nuk mund të paraqesë asnjë dokument tjetër shtesë përvec atyre që ka aplikuar on-line në web-site të UST-së.
- Dokumentacioni i dorëzuar me anë të shërbimit postar dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të këtyre kandidatëve.

**3. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët**

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 10 (dhjetë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit në faqen e UST-së dhe APP.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit si dërgues dhe si marrës; ***Universiteti i Sporteve të Tiranës, Njësia Kryesore, Njësia Bazë, specialiteti ku aplikon.***

## IV. PROCESI I VLERËSIMIT TË KANDIDATURAVE

Vlerësimi i kandidatëve aplikues për personel akademik me kohë të plotë realizohet nga komisioni ad hoc i krijuar me urdhër të Rektorit. Hapat e ndjekura në vlerësimin dhe punësimin e personelit akademik me kohë të plotë janë si më poshtë:

**1. Krijimi i Komisionit ad hoc për punësimin e personelit akademik me kohë të plotë**

- Komisioni ad hoc për konkursin e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë krijohet nga Rektori.
- Komisioni ad hoc për konkursin e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë është në numër tek. Përbëhet nga jo me pak se 5 (pesë) anëtarë, të cilët janë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë dhe që nuk duhet të kenë konflikt interesi me kandidatët pjesmarrës. Komisioni përbëhet nga:
  - Tre anëtarë propozohen nga drejtuesi i njësisë bazë, për të cilin është shpallur procedura e konkurrimit.
  - Një anëtar propozohet nga drejtuesi i njësisë kryesore i cili ka shpallur procedurën e konkurimit;
  - Një anëtar propozohet nga Rektorati i UST-së.
- Caktimi i anëtarëve të komisionit ad hoc dhe pjesmarrja e tyre në komision është e detyrueshme.
- Komisioni ad hoc e ushtron funksionin e tij me një përbërje të plotë dhe në çdo rast me jo më pak se pesë anëtarë.
- Drejtuesi i njësisë kryesore (dekani/ drejtori) si rregull kryeson Komisionin ad hoc.



Rr. Muhamet Gjollesha, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

2. **Detyrat e komisionit ad hoc**

- Komsioni, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim. Vlerësimi i kandidaturave përfshin dy faza të njëpashnjëshme, që janë vlerësimi i dosjes dhe intervista. Vetëm kandidatët e kualifikuar nga faza e shqyrtimit të dosjeve i nënshtrohen intervistës. Komisioni pas zhvillimit të intervistës, shpall kandidatin/ kandidatët fitues. Konkurimi zhvillohet në mjediset e UST-së ku dhe shpallen kandidatët fitues.
- Kryetari i Komisionit njoftohet me Urdhrin për ngritjen e tij dhe listën e kandidatëve aplikues nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit ditën e shpalljes së urdhrit. Kryetari dhe anëtarët e komisionit diskutojnë e vendosin për datën dhe orën për vlerësimin e dokumentacionit të kandidatëve sipas kritereve të miratuara dhe tabelës së vlerësimit duke listuar kandidatët e përzgjedhur për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit.
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit njofton kandidatet fitues të fazës së parë të kandidimit për t'u paraqitur për intervistë pranë ambjenteve të UST-së në ditën dhe orën e caktuar nga komisioni ad hoc.
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore njofton kandidatët që nuk e kanë kaluar fazën e parë të kandidimit që ndërpresin garën e konkurrimit në këtë fazë.
- Procesi i vlerësimit përfundimtar të kandidatëve realizohet nga komisioni ad hoc brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga dita e hapjes së fazës së parë të konkursit.
- Komisioni në prani të të gjithë anëtarëve shqyrton dosjet e kandidatëve duke evidentuar dhe kryer vleresimin në mënyrë të pavarur sipas anekseve bashkëlidhur kësaj rregulloreje, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur për secilin kandidat.
- Komisioni pas evidentimit të dokumentacionit dhe vleresimit merr vendim për kandidaturat që do të vazhdojnë më tej konkurrimin në fazën e dytë.
- Komisioni realizon pikëzimin e dokumentacionit të paraqitur për secilin kandidat dhe merr vendim për zhvillimin e intervistave.
- Komisioni merr vendim për kandidatët e skualifikuar duke renditur arsyet e skualifikimit për secilin prej tyre.
- Komisioni realizon dhe vlerëson intervistat si dhe informon çdo kandidat për pikëzimin e dokumentacionit të tij para intervistës.
- Komisioni vlerëson kandidatët në intervistën e strukturuar për:
    - Aftësitë shprehëse për mënyrën e paraqitjes së filozofisë së mësimdhenies/kërkimt shkencor nga ana e kandidatit.
    - Prezantimin në PowerPoint (ppt) dhe referimin e një temë leksioni apo kërkimi shkencor që lidhet me fushën, specialitetin, lëndën që ai pretendon të mbulojë (mini – leksion/prezantim).
    - Të jetë i gatshëm t'i përgjigjet pyetjeve të ndryshme rreth fushës së studimit.
    - Kandidati duhet të jetë i pregatitur që mund të intervistohet edhe në gjuhën të cilën ai ka të çertifikuar në aplikim.
- Kualifikimi i kandidatëve bëhet duke u bazuar në kriteret e shpallura publikisht.



Rr. Muhamet Gjollesha, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

- Vlerësimi bëhet sipas një sistemi pikësh të përcaktuar paraprakisht dhe të standartizuara sipas një formati tip, nga secili prej anëtarëve dhe më pas bëhet integrimi i vlerësimeve.
- Komisioni pas zhvillimit të intrvistës, rendit kandidaturat sipas pikëzimit total.
- Komisioni vendos dhe propozon renditjen përfundimtare për Rektorin.
- Komisioni ad hoc i paraqet listën me renditjen e kandidatit/ kandidatëve pjesmarrës në konkurs Rektorit të UST-së përmes drejtuesit të njësisë kryesore. Rektori bën shpalljen e kandidatit/ kandidatëve fitues, nënshkruan kontratën e punës me të/ta dhe nga ky moment fillojnë marrëdhëniet e punës.

3. Pikëzimi i dokumenacionit të kanditatëve konkurrues dhe koeficentët është sipas anekseve të pasqyruara në këtë rregullore.

**4. Periudha e zhvillimit të procedurave të konkurrimit**

Kjo periudhë zgjat jo më shumë se 10 (dhjetë) ditë pune nga koha e ngritjes së urdhrit të komisionit ad hoc. Gjatë kësaj periudhe komisioni ka realizuar vlerësimin paraprak të dokumentacionit si dhe intervistat. Kandidati njoftohet elektronikisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit për vendimet e marra nga komisioni për kohën, vendin datën e mënyrën e zhvillimit të intervistës.

**5. Shpallja e fituesit:**

- Shpallja e fituesit bëhet nga Rektori pas miratimit dhe klasifikimit përfundimtar.
- Kandidatët njoftohen elektronikisht për rezultatin nga Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit me e-mail. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit njofton kandidatin fitues, harton kontratat e punës si dhe njesia përkatëse harton akt-marrëveshjen.
- Aplikantëve u garantohet e drejta të ankimojnë vlerësimin dhe rezultatet e konkursit, duke paraqitur kërkesë formale dhe duke parashtruar arsyet dhe shkaqet për të cilat paraqesin ankimin, brenda 2 ditëve të punës nga shpallja e rezultateve. Ankimi paraqitet tek Rektori i UST-së, i cili e shqyrton dhe vendos mbi ankimimin për rishikim nga komisioni i ankimimeve.
- Në rast të konstatimit të parregullsive në zbatimin e procedurave dhe te vleresimit, Rektori vendos pavlefshmërinë e procesit dhe ripërsëritjen e tij.
- Rektori emëron kandidatin fitues dhe nënshkruan kontratën e punës.



Rr. Muhamet Gjollesha, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

## ANEKSI I

**LENDA: Kritere të vlerësimit të kandidatit/ve për konkurim për vend të lirë pune për personel akademik në**
**Departamentin .....**
**Fakultetit të.....**

### A. KATEGORIA: "Asistent Lektor"

### I. KRITERE TË PËRGJITHSHME – KRITERE ELEMINUESE

| I | KRITERE ELIMINUESE |
|---|---|
| 1 | Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës. Ai duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri). |
| 2 | Të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të mbi 8. Nqse njëri nga kandidatët ka mbaruar specilizime afatgjata do të ekuivalentohet nota mestare me studimet Bachelor, Master i Shkencave dhe Specilizime afatgjata. |
| 3 | Të ketë notë mesatare 8-të e lart në studimet e nivelit "Bachelor", DIND, Master Shkencor dhe Specializime Afatgjata, si dhe specialiteti i lëndës që konkuron duhet të jetë 8 e lart. Dominante në vlerësimin e notës mesatare është Masteri Shkencor ose DIND, dhe Specializimet Afatgjata kur ato poseidohen.<br>Për çdo 0.1 notë më shumë se 8.00, shtohet me 1 pikë në vlerësim, gjithsej 20 pikë.<br>Për kandidatët që kanë notë mesatare 9.5 e lart jeper 5 pikë bonus, si studentë të Ekselencës. |
| 4 | Të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht) të fitura konform legjislacionit në fuqi. |
| 5 | Të ketë zotësi të plotë për të vepruar. |
| 6 | Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata. |
| 7 | Të mos ketë prishur imazhin e UST-së. |
| ***Shënim:*** *Në rast mosplotësimi të kritereve më siper dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.* | |

### II. KRITERE TË VEÇANTA

| II | KRITERE PËR VLERËSIM | Vlerësimi (pikë) |
|---|---|---|
| 1 | **Shkollimi:** | ***Deri në 25 pikë*** |
| | **Të ketë notë mesatare 8-të e lart në studimet e nivelit "Bachelor", DIND, Master Shkencor dhe Specializime Afatgjata. (për çdo 0.1 notë = 1 pikë) përjashtuar rastet sipas** *pikës 7, VKM nr.57, datë 29.01.2020* **(vertetuar nga ministria përkatëse)**<br>Për kandidatët që kanë notë mesatare 9.5 e lart jeper 5 pikë bonus, si studentë të Ekselencës. | |
| 2 | **Përvojë pune në fushën e studimit dhe mësimdhënie** | ***Deri në 5 pikë*** |
| | Për çdo vit eksperience në mësimdhenie me kohë të plotë në universitet<br>(1 vit = 2 pikë , por jo më shumë se 5 vjet). | |
| | Për çdo vit eksperience në mësimdhenie me kohë të pjesshme në universitet<br>(1 vit = 1 pikë, por jo më shumë se 5 vjet) | |
| 3 | **Kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit** | ***Deri në 5 pikë*** |
| | Kurs kualifikimi **brenda vendit** në fushën e profesionit, i vërtetuar me dëshmi<br>(1 kurs = 0.5 pikë, të njohura zyrtarisht, deri në 5 pikë) | |



Rr. Muhamet Gjollesha, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

| | | |
|---|---|---|
| | Kurs kualifikimi **jashtë vendit** në fushën e profesionit i vërtetuar me deshmi<br>(1 kurs = 1 pikë dhe të njohura zyrtarisht) | |
| 4 | Vlerësohen kualifikime të ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së lëndës.<br>*(Vlerësohen me pikë kualifikimet 3 muaj e më shumë).* | ***Deri në 15 pikë*** |
| | Kualifikime brënda vëndit (3 muaj = 2 pikë) | |
| | Kualifikime jashtë vëndit të njohura zyrtarisht në Republikën e Shqipërisë<br>(3 muaj = 4 pikë). | |
| | Specializimet Afatgjatë dhe/ose Master Ekzekutiv | |
| 5 | **Njohuri të gjuhëve perëndimore (anglisht, italisht, giermanisht, frëngjisht, dhe spanjisht)** e vërtetuar me dëshmi nga kurset intern (nuk njihet asnje dëshmi tjeter jashtë ketij kriteri). | ***Deri në 5 pikë*** |
| | **niveli C1 = 3 pikë, B2 = 2 pikë, gjuha e dytë = 2 pikë** | |
| 6 | **Referime në:** | ***Deri në 6 pikë*** |
| | Konferenca, kongrese, simpoziume **brenda** vendit të nivelit universitar, numër pjesemarrjesh (çertifikatë):<br>1 pjesëmarrje = 1 pikë, por jo më shumë se **4 pikë**.<br>Pjesëmarrje me botim (poster dhe oral) "**Proccedings**"të indeksuara me kod ISBN ose ISSN, të njohura zyrtarisht në RSH:<br>autor i parë ose i dytë = **2 pikë**; autor i tretë në vijim = **1 pikë**) | |
| | Konferenca, kongrese, simpoziume, **jashtë** vendit, me botim (poster dhe oral) në **"Proccedings"** të indeksuara me kod ISBN ose ISSN, të vendeve të OECD-së, BE-së ose G20-ës;<br>autor i parë ose i dytë = **3 pikë**; autor i tretë në vijim = **1 pikë**) | |
| 7 | **Botime artikuj shkencor:** | ***Deri në 9 pikë*** |
| | Botime në revista të njohura zyrtarisht nga MA **brenda vendit**: autor i parë ose i dytë = 2 pikë; autor i tretë e në vijim = 1pikë) | |
| | Botime **jashtë vendit**:<br>a) botimet në revistat e indeksuara ndërkombëtare marrin (poster dhe oral):<br>autor i parë ose i dytë = **3 pikë**; autor i tretë e në vijim = **1 pikë**.<br>b) botim ne revista të indexuar SCOPUS/ ose me faktor impakti të indeksuara (autor i parë ose i dytë) vleresohet deri në **5 pikë; autor i tretë e në vijim = 2 pikë** | |
| **Totali i Pikëve të Dosjes = 70 pikë** | | **70 pikë** |
| **II** | **Intervista me Gojë, Pikë = 30 pikë** | **30 pikë** |
| **TOTALI PIKËVE = totali i pikëve të dosjes + totali i pikëve të intervistës** | | **100 pikë** |

***Kujdes & Konsideroni:***

- *Vlerësimi me pikë do të rrumbullakoset, fiksohet 0.6, që do të kalojë një njësi më lart: Shembull 8.15 = 1 pikë dhe 8.16 = 2 pikë.*
- *Në kushtet kur kandidatët kanë pike te barabarta preferohet kandidati që ka kryer studimet (Bachelor dhe/ose Master, dhe/ose Doktoratë jashtë vendit).*



Rr. Muhamet Gjollesha, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

## ANEKSI II

**Lënda: Kritere të vlerësimit të kandidatit/ve për konkurim për vend të lirë pune për personel akademik në**
**Departamentin .....**
**Fakultetit të.....**

### B. KATEGORIA: "LEKTOR"

### I. KRITERE TË PËRGJITHSHME – KRITERE ELEMINUESE

| I | **KRITERE ELIMINUESE** |
|---|---|
| 1 | Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës |
| 2 | Të mbajë të paktën gradën shkencore "Doktor".<br>(Grada shkencore e mbrojtur në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri). |
| 3 | Të ketë zotësi të plotë për të vepruar. |
| 4 | Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata; |
| 5 | Të mos ketë prishur imazhin e UST-së; |
| ***Shënim:*** *Në rast mosplotësimi të kritereve më siper dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.* | |

### II. KRITERE TË VEÇANTA

| I | **KRITERE PËR VLERËSIM** | **Vlerësimi (pikë)** |
|---|---|---|
| 1 | **Shkollim:** | ***Deri në 10 pikë*** |
| | Doktoratë jashtë vendit (në vendet e BE &OECD) (brenda fushës që kandidon) = **10 pikë.** | |
| | Doktoratë brenda vendit (brenda fushës që kandidon) = **8 pikë.** | |
| 2 | **Të ketë përvojë pune në mësimdhënie:** | ***Deri në 10 pikë*** |
| | Për çdo vit eksperience në mësimdhenie me kohë të plotë në universitet<br>1 vit = **2 pikë**, por jo më shumë se 5 vjet. | |
| | Për çdo vit eksperience në mësimdhenie me kohë të pjesshme në universitet<br>1 vit = **0.5 pikë**, por jo më shumë se 5 vjet. | |
| 3 | **Njohuri të gjuhëve perëndimore (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht, dhe spanjisht)** e vërtetuar me dëshmi nga kurset intern. Legjislacioni në fuqi. Nuk njihet asnjë dëshmi tjetër jashtë këtij kriteri. | ***Deri në 5 pikë*** |
| | **niveli C1 = 3 pikë, B2 = 2 pikë, gjuha e dytë = 2 pikë** | |
| 4 | **Botime:** | ***Deri në 20 pikë*** |
| | Tekst mësimor të aprovuar nga departamenti përkatës (autor i parë ose i dytë), vleresohet deri në **2 pikë; autor i tretë e në vijim = 1 pikë** | |
| | Artikull / artikuj shkencorë (brenda fushës) të botuar brenda vendit në revista të njohura zyrtarisht nga MA (autor i parë ose i dytë) vleresohet deri në **2 pikë; autor i tretë e në vijim = 1 pikë** | |



Rr. Muhamet Gjollesha, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

| | | |
|---|---|---|
| | Artikull / artikuj shkencorë (brenda fushës) të botuar jashtë vendit në revista të indeksuara me kod ISBN ose ISSN, të vendeve të OECD-së, BE-së ose G20-ës (autor i parë ose i dytë) vleresohet deri në **3 pikë; autor i tretë e në vijim = 1 pikë** | |
| | Artikull / artikuj shkencorë (brenda fushës) të botuar jashtë vendit te indexuar SCOPUS/ ose me faktor impakti të indeksuara (autor i parë ose i dytë) vleresohet deri në **5 pikë; autor i tretë e në vijim = 2 pikë** | |
| 5 | **Referime në:** | ***Deri në 15 pikë*** |
| | Konferenca, kongrese, simpoziume brenda vendit të nivelit universitar, numër pjesemarrjesh me botim te plote në **"Proccedings"**të indeksuara me kod ISBN ose ISSN, të njohura zyrtarisht në RSH; " (autor i pare ose i dytë), vleresohet **me 2 pikë; autor i tretë e në vijim 1 pikë** | |
| | Konferenca, kongrese, simpoziume, jashtë vendit, me botim të plotë në **"Proccedings"** të indeksuara me kod ISBN ose ISSN, të vendeve të OECD-së, BE-së ose G20-ës; (autor i parë ose i dytë), vleresohet **me 3 pikë, autor i tretë e në vijim = 1 pikë** | |
| 6 | **PROJEKTE = *drejtues/ anëtar*** | ***Deri në 10 pikë*** |
| | Projekt kombëtar: drejtues projekti = **4 pikë**; anëtar projekti = **2 pikë**. | |
| | Projekt ndërkombëtar: drejtues projekti = **6 pikë**; anëtar projekti = **3 pikë**. | |
| **Totali Pikëve të Dosjes = 70 pikë** | | **70 pikë** |
| **II** | **Intervista me Gojë, pikë = 30 pikë** | **30 pikë** |
| **TOTALI PIKËVE = totali i pikëve të dosjes + totali i pikëve të intervistës** | | **100 pikë** |

***Kujdes & Konsideroni:***

- *Vlerësimi me pikë do të rrumbullakoset, fiksohet 0.6, që do të kalojë një njësi më lart:*
  *Shembull 8.15 = 0.5 pikë dhe 8.16 =1 pikë*
  *Në kushtet kur kandidatët kanë pikë të barabarta preferohet kandidati qe ka kryer studimet (Bachelor dhe/ose Master, dhe/ose Doktorate jashtë vendit).*



Rr. Muhamet Gjollesha, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

## ANEKSI III

**LËNDA: Kritere të vlerësimit të kandidatit/ve për konkurim për vend te lirë pune për personel akademik në**
**Departamentin .....**
**Fakultetit të.....**

### C. KATEGORIA: "Profesor"

### I. KRITERE TË PËRGJITHSHME – KRITERE ELEMINUESE

| I | KRITERE ELIMINUESE |
|---|---|
| 1 | Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës. |
| 2 | Të mbajë të paktën titullin shkencor "Profesor i Asociuar".<br>(Titulli akademik i lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri) |
| 3 | Të ketë zotësi të plotë për të vepruar; |
| 4 | Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata; |
| 5 | Të mos ketë prishur imazhin e UST-së. |
| ***Shënim:*** *Në rast mosplotësimi të kritereve më siper dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.* | |

### II. KRITERE TE VEÇANTA

| I | KRITERE PËR VLERËSIM | Vlerësimi (pikë) |
|---|---|---|
| 1 | **Shkollimi:** | ***Deri në 15 pikë*** |
| | Titulli "Profesor", vlerësimi = **15 pikë** | |
| | Titulli "Profesor i Asociuar", vleresimi = **10 pikë** | |
| 2 | **Të ketë përvojë pune në mësimdhënie:** | ***Deri në 10 pikë*** |
| | Për çdo vit eksperience në mësimdhenie me kohë të plotë në universitet<br>1 vit = **2 pikë**, por jo më shumë se 5 vjet. | |
| | Për çdo vit eksperience në mësimdhenie me kohë të pjesshme ne universitet<br>1 vit = **0.5 pikë**, por jo më shumë se 5 vjet. | |
| 3 | **Njohuri të gjuhëve perëndimore (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht, dhe spanjisht)** e vërtetuar me dëshmi nga kurset intern. Legjislacioni në fuqi. Nuk njihet asnjë dëshmi tjetër jashtë këtij kriteri. | ***Deri në 5 pikë*** |
| | **niveli C1 = 3 pikë, B2 = 2 pikë, gjuhë të tjera = 2 pikë** | |
| 4 | **Botime:** | ***Deri në 20 pikë*** |
| | Tekst mësimor të aprovuar nga departamenti përkatës (autor i parë ose i dytë), vleresohet deri në **2 pikë; autor i tretë e në vijim = 1 pikë** | |
| | Artikull / artikuj shkencorë (brenda fushës) të botuar brenda vendit (autor i parë ose i dytë) vleresohet deri në **3 pikë; autor i tretë e në vijim = 1 pikë** | |



Rr. Muhamet Gjollesha, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

| | | |
|---|---|---|
| | Artikull / artikuj shkencorë (brenda fushës) të botuar jashtë vendit (autor i parë ose i dytë) vleresohet deri në **4 pikë; autor i tretë e në vijim = 1 pikë** | |
| | Artikull / artikuj shkencorë (brenda fushës) te botuar jashtë vendit te indexuar SCOPUS/ ose me faktor impakti të indeksuara (autor i parë ose i dytë) vleresohet deri në **5 pikë; autor i tretë e në vijim = 2 pikë** | |
| 5 | **Referime në:** | ***Deri në 10 pikë*** |
| | Konferenca, kongrese, simpoziume brenda vendit, numër pjesemarrjesh me botim te plote në "**Proccedings**"të indeksuara me kod ISBN ose ISSN, të njohura zyrtarisht në RSH; " (autor i pare ose i dytë), vleresohet **me 2 pikë, autor i tretë e në vijim 1 pikë** | |
| | Konferenca, kongrese, simpoziume, jashtë vendit, me botim te plote ne "**Proccedings**" të indeksuara me kod ISBN ose ISSN, të vendeve të OECD-së, BE-së ose G20-ës; (autor i pare ose i dytë), vleresohet **me 4 pikë, autor i tretë e në vijim 2 pikë.** | |
| 6 | **PROJEKTE = d*rejtues/ anëtar*** | ***Deri ne 10 pikë*** |
| | Projekt kombëtar: drejtues projekti = **4 pikë**; anëtar projekti = **2 pikë**. | |
| | Projekt ndërkombëtar: drejtues projekti = **6 pikë**; anëtar projekti = **3 pikë**. | |
| **Totali i Pikëve të Dosjes = 70** | | **70 pikë** |
| **II** | **Intervista me Gojë, Pikë = 30** | **30 pikë** |
| **TOTALI PIKËVE = totali i pikëve të dosjes + totali i pikëve të intervistës** | | **100 pikë** |



Rr. Muhamet Gjollesha, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

## B. LËVIZJET PARALELE PËR STAFIN AKADEMIK

**1. Lëvizja paralele e personelit akademik për nevojat emeregjente të njësive kryesore (fakulteteve)** në Universitetin e Sporteve të Tiranës, lejon transferimin e një punonjësi brenda universitetit në një pozicion të të njëjtit nivel, për plotësimin e nevojave emergjente të një njësie baze (departamenti), edhe pa pasur nevojë për një konkurs të hapur publik të jashtëm.

**1.1. Nismat dhe arsyetimi i nevojës emergjente**

- Drejtuesi i njësisë bazë (departamentit) që ka nevojë për staf, i drejton një kërkesë të argumentuar Dekanit të Fakultetit, i cilë pas miratimit e përcjell këtë kërkese pranë Rektorit të UST- së.
- Rektori i UST-së shprehet me vendim për këtë lëvizje paralele pasi të ketë marrë miratimin me shkrim nga drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë, si dhe të stafit akademik që kërkohet të lëvizë.

**2. Lëvizja paralele e personelit akademik për nevojat e njësive kryesore (fakulteteve)** në Universitetin e Sporteve të Tiranës, për secilin pozicion te lire bëhet me konkurs të hapur publik brenda Universitetit.

**2.1.** Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë proçedurë janë:

- Kandidati që kërkon të lëvizë, duhet të ketë miratimin me shkrim të drejtuesit të njësisë kryesore, drejtuesit të njësisë bazë ku ai bën pjesë, si dhe të Rektorit të UST-së.
- Të plotësojë kushtet dhe kërkesat specifike dhe preferenciale të përcaktuara nga njësia bazë ku është krijuar vendi i lirë.

Kriteret specifike dhe preferenciale të personelit akademik me kohë të plotë (lëvizje paralele) përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit dhe miratohen nga Drejtuesi i njesise kryesore dhe Rektori i UST-së.
Proçedura e konkurrimit dhe e punësimit është e vlefshme edhe në rastet kur paraqitet vetëm një kandidaturë e cila plotëson kriteret e vendosura për konkurrim.

**2.2.** Shpallja e vendit të lirë të punës përmban këto të dhëna:

a. Pozicionin për vendin vakant;
b. Përshkrimin e përgjithshëm të punës për atë pozicion;
c. Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret specifike dhe ato preferenciale që duhet të plotësojnë kandidatët;
d. Dokumentet që duhet të dorëzohen dhe mënyra e dorëzimit të tyre;
e. Afatet e dorëzimit'
f. Numri i personelit të kërkuar për pozicionin/et e kërkuara;
g. Kritere të përgjithshme të kualifikimit;
h. Afatin e zhvillimit të procedurave të vleresimit te dosjeve te kandidatit.

**2.3.** Shpallja është e hapur për të gjithë punonjësit akademik të UST-së të së njëjtës kategori.
Dokumentacioni duhet të dorëzohet brenda datës së përcaktuar në shpalljen për vleresim te kandidaturave pranë zyrës së Arkiv/Protokollit të UST-së. Kjo datë përcaktohet duke siguruar që afati



Rr. Muhamet Gjollesha, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

i dorëzimit të dokumentacionit të mos jetë më i vogël se 5 ditë pune nga dita e parë e shpalljes se vendit te lire te punes ne ambjentet dhe ëeb-site të UST-së.

**2.3.** Vlerësimi i dosjeve te kandidatëve që kandidojne për një vend të lirë për personel akademik (lëvizje paralele) të UST, bëhet nga komisione të posaçme (Ad Hoc). Dekanët/Drejtori i secilit fakultet/institut paraqesin në Rektorat përbërjen e komisioneve të vlerësimit të kandidatëve, për secilin specialitet, i cili i nënshtrohet miratimit. Komisionet përbëhen nga të paktën 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 1 (një) përfaqësues i Rektoratit, 2 (dy) nga njësia kryesore dhe 2 (dy) të tjerë nga njësitë bazë.

**2.4.** Komisionet në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit marrin në shqyrtim paketat e aplikimit të kandidatëve, brenda 2 (dy) ditëve të punës nga data e krijimit të tij, si dhe verifikojnë përputhshmërinë e informacionit të formularit të aplikimit dhe dokumentacionin përkatës. Kandidatët njoftohen elektonikisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit rreth fokusit të intervistës.

**2.5.** Komisioni në prani të gjithë anëtarëve hap dosjet e kandidatëve duke evidentuar e vleresuar me pike nga çdo anetare i komisionit ad hoc për çdo rubrike të formularit tip të vleresimit (në mënyrë të pavarur). Kjo mbledhje e komisionit dokumentohet me proces verbal.

**2.6.** Komisioni pas evidentimit dhe vleresimit ne baze të dokumentacionit merr vendim për kandidaturat duke i listuar ato sipas pikeve.

**2.7.** Klasifikimi i kandidatëve bëhet duke u bazuar në kriteret e shpallura. Eksperienca dhe formimi i kandidatëve të klasifikuar, duhet t'i përgjigjen sa më mirë përshkrimit të vendit të punës.

**2.8.** Vlerësimi bëhet sipas një sistemi pikësh të përcaktuar paraprakisht ne formularin e vleresimit, nga secili prej anëtarëve te komisionit ad hoc dhe më pas bëhet integrimi i vlerësimeve.

**2.9.** Komisioni, në përfundim të vlerësimit, rendit kandidatët sipas pikeve te fituara ne rendin zbrites dhe përcjell në Rektorat listën përfundimtare me Vendimin për kandidatin fitues.

**2.10.** Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit, njofton konkurrentët për rezultatin e tyre, brenda 24 (njëzetë e katër) orëve në mënyrë elektronike.

**2.11.** Kandidati që nuk është fitues, ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim për rezultatin e pikëve, brenda 2 (dy) ditëve të punës nga data e njoftimit për rezultatin e vlerësimit. Ankimuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve të punës nga data e përfundimit të afatit të ankimimit.

**2.13.** Njësia përgjegjëse, brenda 2 (dy) ditëve të punës, pas përfundimit të proçedurave të ankimit, shpall fituesin dhe bën aktin e emërimit të kadidatit nga Rektori.

**2.14.** Personeli akademik detyrohet të bëjë dorëzimet në pozicionin e mëparshëm të punës brenda 5 (pesë) ditëve pune.



Rr. Muhamet Gjollesha, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

## C. PROCEDURA E PUNËSIMIT PËR PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS (TË JASHTËM)

Për nevoja të Departamenteve në Universitetin e Sporteve të Tiranës për mbulimin e procesit mësimor e më gjërë, krahas personelit me kohë të plotë, punësohet edhe personel akademik me kohë të pjesshme. Punësimi i personelit akademik me kohë të pjesshme në Universitetin e Sporteve realizohet me konkurs. Konkursi zhvillohet në njësinë përkatëse.

Hapat e ndjekura në punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme janë si më poshtë:

- Njësitë kryesore, me propozim të njësive bazë, të cilat përcaktojnë nevojat e tyre për personel akademik joefektiv, i kërkojnë Rektorit miratimin e personelit akademik me kontratë të përkohshme. Ky propozim mund të realizohet vetëm nëse ngarkesa mësimore nuk plotësohet me personelin akademik me kohë të plotë. Rektori, duke u mbështetur në propozimet e njësive kryesore dhe në varësi të fondit të miratuar për këtë qëllim, miraton çdo vit listën emërore të personelit akademik me kontratë të përkohshme.
- Kjo kontratë do të nënshkruhet nga Rektori për një punë të caktuar ose për një periudhë kohe të caktuar.

Njësitë kryesore dhe njësitë bazë në propozimet e tyre duhet të marrin për bazë përvojën profesionale dhe akademike të kandidatëve. Ata duhet që të plotësojnë minimalisht këto kritere:

a. Në programin "Bachelor", duhet të kenë përfunduar studimet në programin "Master i Shkencave"
b. Në programin "Master i Shkencave" dhe "Master Profesional", duhet të kenë gradën shkencore "Doktoratë"
c. Në programin e shkollës së Doktoratës, duhet të jenë pjesë e kategorisë "Profesor";

### I. SHPALLJA PUBLIKE E KONKURRIMIT:

1. Në web-in e UST-së bëhet shpallja e konkurrimit për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme. Njoftimi për nevojën për personel akademik bëhet publik nga Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Arkiv/ Protokollit nëpërmjet faqes zyrtare të UST-se.

2. Shpallja publike e konkurrimit duhet të përmbajë këto të dhëna:
   a. pozicioni për vendin vakant;
   b. numri i personelit të kërkuar për pozicionin/et e kërkuara;
   c. kritere të përgjithshme të kualifikimit;
   d. kritere specifike të kualifikimit;
   e. kriteret preferenciale;
   f. dokumentet që duhet të dorëzohen;
   g. mënyrën dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit;
   h. Afatin e zhvillimit të procedurave të vleresimit te kandidateve.



Rr. Muhamet Gjollesha, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

## II. KRITERET E KUALIFIKIMIT:

Kriteret e kualifikimit përbëhen nga kritere të përgjithshme, kritere specifike dhe kritere preferenciale të kualifikimit.

***Kandidatët që konkurrojnë*** për personel akademik me kohë të pjesshme, duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme, specifike dhe preferenciale sipas kategorisë përkatëse.

***Kriteret e përgjithshme të kualifikimit*** janë si më poshtë:

1. ***Për personel akademik i kategorisë "Profesor":***
   a. Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.
   b. Të mbajë të paktën titullin shkencor "Profesor i Asociuar".
   (Titulli akademik i lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri)
   c. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurojnë, në përputhje me normat e vendosura në percaktimin e kritereve të punësimit për staf akademik me kohë të plotë në UST;
   d. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;
   e. Të mos ketë prishur imazhin e UST-së;
   f. Të ketë veprimtari kërkimore-shkencore dhe botime në disiplinën përkatëse.
   g. Të plotësojë kriteret e propozuara nga njësia bazë përkatëse.

2. ***Për personel akademik i kategorisë "Lektor":***
   a. Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.
   b. Të mbajë të paktën gradën shkencore "Doktor".
   c. (Grada shkencore e mbrojtur në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurojnë, në përputhje me normat e vendosura në percaktiimin e kritereve te punesimit per staf akademik me kohe te plote ne UST;
   d. Të ketë të paktën 2 vite përvojë pune në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë brenda apo jashtë vendit.
   e. Të ketë veprimtari kërkimore-shkencore dhe botime në disiplinën përkatëse.
   f. Të plotësojë kriteret e propozuara nga njësia bazë përkatëse.
   g. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;
   h. Te mos kete prishur imazhin e UST-së;



Rr. Muhamet Gjollesha, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

3. ***Për personel akademik i kategorisë "Asistent-Lektor".***
   a. Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës. Ai duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri):
   ***d.1.*** Të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të mbi 8, si dhe specialiteti i lëndës që konkuron duhet të jetë mbi 8 .
   ***d.2.*** Përjashtohen nga kërkesa e pikës d.1), vetëm kandidatët që rekrutohen si instruktor i certifikuar në specialitetin përkatës, në akivitetet mësimore praktike (outdoor), për programet e sporteve në natyrë.
   b. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurojnë, në përputhje me normat e vendosura në percaktiimin e kritereve te punesimit per staf akademik me kohe te plote ne UST;
   c. Të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht)
   d. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;
   e. Të mos ketë prishur imazhin e UST-së;

***Kriteret specifike*** dhe ato preferenciale të kualifikimit të propozuara nga njësia bazë përkatëse i përcillen për miratim Rektorit nga Drejtuesi i Njësisë Kryesore.

Procedura e konkurrimit dhe e punësimit është e vlefshme edhe në rastet kur paraqitet vetëm një kandidaturë e cila plotëson kriteret e vendosura për konkurrim.

## III. PROCESI I DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT

1. ***Lista e dokumenteve që duhet të paraqesë kandidati për konkurrim***
   a) Formular aplikimi;
   b) Letër motivimi dhe shprehje interesi për lenden/modulin qe kandidati aplikon.
   c) Një kopje jetëshkrimi i fokusuar ne eksperiencat ne mesimdhenie dhe botim shkencore;
   d) Kopje e noterizuar diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
   e) Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm origjinal ose të noterizuar, sipas plotësimit të kritereve të shpallura;
   f) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
   g) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti)/ formulari i vetdeklarimit;



Rr. Muhamet Gjollesha, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

h) Vërtetim nga qendra e punes per t'u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme ne institucionin tonë. (nqs është i punësuar, e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon.(dorezohet nese shpallet fitues)
i) Librezë shëndetësore nga Qëndra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

**2. *Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit***

Dokumentacioni i plotësuar sipas kritereve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik, duhet të dorëzohet në adresën e përcaktuar në njoftim që është:

- Dorëzimi i dokumentacionit bëhet nëpërmjet **rrugës postare**:
- Vetem paketat e aplikimit të mbërritura me anë të aplikimit elektronik ose shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit (derguesi); pastaj sipas renditjes (marrësi) 1) Universiteti i Sporteve të Tiranës, 2) Njësia Kryesore, 3) Njësia bazë, 4) **specialiteti ku aplikon** (lënda), emri, mbiemri.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

**3. *Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët***

Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 5 (pese) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit. Kandidati duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pese) ditëve punës nga data e publikimit të njoftimit dhe e dorëzon atë të mbyllur në zarf me rrugë postare ose të gjithë paketen me dokumenta e dërgon elektronikisht në web-site të UST .

## IV. PROCESI I VLERËSIMIT TË KANDIDATURAVE

Vlerësimi i kandidatëve aplikues për personel akademik me kohë të pjesshme realizohet nga komisioni *ad hoc* i krijuar me urdhër të dekanit.

Konkurimi për personel akademik me kontratë të përkohëshme bëhet nëpërmjet vlerësimit të dosjeve nga njësia bazë. Pranohet si kandidaturë qoftë dhe kur paraqitet një dosje nqse kandidati plotëson kriteret. Perjashtohën rastet kur personeli akademik me kontratë të përkohëshme është kategoria "Profesor", të cilët duhet të paraqesin: CV të plotë; dokumentin zyrtarë që verteton titullin akademik. Në rast të pjesëmmarrjes në konkurs të më shumë se 1 (një) kandidati, është intervista që bën diferencën.

Pikëzimi i dokumenacionit të kandidatëve konkurrues dhe koeficentët është sipas aneksit IV, V dhe VI të pasqyruara në këtë rregullore.



Rr. Muhamet Gjollesha, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

## ANEKSI IV

**LENDA: Kritere të vleresimit të kandidatëve për konkurim për vend të lirë pune për personel akademik me kohë të pjesshme në**
**Dep.....**
**Fakultetit të .....**

**A KATEGORIA: "Asistent Lektor"**

### I. KRITERE TË PËRGJITHSHME – KRITERE ELEMINUESE

| I | KRITERE ELIMINUESE |
|---|---|
| 1 | Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës. Ai duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i Shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri). |
| 2 | Të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të mbi 8. Nqse njëri nga kandidatët ka mbaruar specilizime afatgjata do të ekuivalentohet nota mestare me studimet Bachelor, Master i Shkencave dhe Specilizime afatgjata. |
